

GJYKATA EVROPIANE E TË DREJTAVE TË NJERIUT  
SEKSIONI I TRETË

**VENDIM**

Kërkesa nr. 9227/19  
Besnik Keta kundër Shqipërisë

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Seksioni i Tretë), e mbledhur më 11 qershor 2024, si një Komitet i përbërë nga:

Ioannis Ktistakis, *kryetar,*

Darian Pavli,

Andreas Zünd, *gjyqtarë*

dhe Olga Chernishova, *zëvendëssekretare e Seksionit,*

duke mbajtur në konsideratë:

kërkesën (nr. 9227/19) kundër Republikës së Shqipërisë të depozituar në Gjykatë në mbështetje të nenit 34 të Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (“Konventa”) më 5 shkurt 2019 nga një shtetas shqiptar, z. Besnik Keta (“kërkuesi”), lindur në vitin 1977, banues në Tiranë dhe i përfaqësuar nga z. A. Kasapi, avokat i cili e praktikon ligjin në Tiranë,

vendimin për të njoftuar qeverinë shqiptare (“Qeveria”) – përfaqësuar nga agjenti i saj në atë periudhë, z. A. Metani dhe në vijim nga z. O. Moçka, Avokat i Përgjithshëm i Shtetit – për ankesat e bëra në lidhje me të drejtën e kërkuesit për t’u informuar në mënyrën e duhur për arsyet e ndalimit dhe arrestimit të tij me burgim, dhe për të deklaruar të papranueshëm pjesën e mbetur të kërkesës;

vërejtjet e palëve,

pasi diskutoi, vendos si më poshtë:

**LËNDA E ÇËSHTJES**

1. Çështja ka të bëjë me problematikat e ngritura në mbështetje të nenit 5 §§ 2, në lidhje me informacionin që i është dhënë kërkuesit për akuzat ndaj tij dhe mundësinë e procedurave për të kundërshtuar ligjshmërinë e paraburgimit të tij.

2. Kërkuesi u arrestua më 22 dhjetor 2018 *in flagrante delicto* për posedim të lëndëve narkotike, në momentin kur dy oficerë policie, të cilët e ndaluan kërkuesin në rrugë, i gjetën dy çanta me pluhur të bardhë, të dyshuar si lëndë narkotike. Menjëherë pas kësaj, në orën 02:20 të pasdites, policia bëri një kontroll në banesën e kërkuesit, ku kërkuesi i orientoi në një vend të fshehur, ku mbante lëndë narkotike dhe një peshore. Kërkuesi u shoqërua në rajonin e policisë ku u mor në pyetje në orën 05:30 të pasdites në praninë e avokatit të tij. Ai u vu në dijeni për akuzat ndaj tij dhe të drejtat e tij, dhe ai pohoi se i kuptonte ato. Ai pohoi, gjithashtu, se kishte qenë përdorues i lëndëve narkotike prej disa kohësh dhe se lënda narkotike që i ishte gjetur në trup dhe në banesë ishte për përdorim personal. Procesverbali i arrestimit të kërkuesit u përpilua në po të njëjtën ditë në orën 19:00. U përshkruan rrethanat në të cilat ishte arrestuar kërkuesi, dhe u theksua se kërkuesi dyshohej për kryerjen e veprës penale të prodhimit dhe tregtimit të lëndëve narkotike, parashikuar në nenin 283 § 1 të Kodit Penal.

3. Kërkuesit iu dha menjëherë një kopje e procesverbalit dhe ai e nënshkroi atë pa asnjë koment.

4. Më 25 dhjetor 2018, Gjykata e Rrethit Tiranë e kaloi kërkuesin në arrest shtëpie. Më 16 janar 2019, Gjykata e Apelit Tiranë e ndryshoi vendimin e Gjykatës së Rrethit të datës 25 dhjetor 2018, duke urdhëruar paraburgim ndaj kërkuesit. Gjykata e Apelit theksoi se kërkuesi ishte gjetur në posedim të një sasi kokaine që qartazi nuk ishte për përdorim personal, dhe një sasi e vogël ishte gjendur edhe në banesën e tij. Rrethana të tilla mbështesnin dyshimin se kërkuesi ishte përfshirë në një vepër penale

në cilësinë e “shpërndarësit të drogës”. Për këtë arsye, ndalimi i tij me burgim ishte i nevojshëm për parandalimin e përsëritjes së veprës penale.

5. Në apelimin e tij të radhës në Gjykatën e Lartë, kërkuesi u ankua se nuk kishte pasur shkaqe që ai të dërgohej në paraburgim, se nuk ishte bërë menjëherë me dije pas arrestimit të tij në lidhje me akuzat ndaj tij, dhe se avokatit të tij nuk i ishte dhënë ndonjë dokument në lidhje me akuzat në mënyrë që të përgatitej për mbrojtjen e kërkuesit.

6. Më 10 prill 2019, apelimi u rrëzua menjëherë nga Gjykata e Lartë e cila vlerësoi se kërkuesi nuk ishte mbështetur në asnjë prej shkaqeve për apelim të parashikuar në nenin 432 të Kodit të Procedurës Penale. Këto shkaqe përfshijnë rastet kur e drejta penale nuk është respektuar ose kur kjo e drejtë është zbatuar në mënyrën e gabuar; kur ka pasur shkelje të cilat kanë bërë që vendimi i gjykatës të shpallet i pavlefshëm; ose kur ka pasur shkelje të rregullave proceduralë që kanë ndikuar në miratimin e vendimit.

7. Në procedurat penale kryesore ndaj kërkuesit, ai i dënua sipas akuzave dhe iu dha një dënim i pezulluar. Këto procedura u përmbyllën me anë të vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë më 13 maj 2020.

## VLERËSIMI I GJYKATËS

### A. Fusha e veprimit e çështjes

8. Në kërkesën e tij fillestare, ashtu si edhe në përgjigjen e tij ndaj vërejtjeve të Qeverisë, kërkuesi u ankua edhe në mbështetje të nenit 6 §§ 1 dhe 3 të Konventës për shkeljen e një sërë aspektesh të të drejtave të tij për mbrojtje në procedurat kryesore penale ndaj tij. Në fazën e komunikimit, këto ankesa u shpallën të papranueshme nga kryetari i Seksionit, i mbledhur si një gjyqtar i vetëm (sipas rregullave 27A § 2 (a) dhe 54 § 3 të Rregullores së Gjykatës interpretuar së bashku me rregullën 12), dhe për pasojë, Qeveria nuk u vu në dijeni për këto ankesa. Një vendim i tillë është i formës së prerë (neni 27 § 2 i Konventës dhe rregulla 54 § 3), dhe për këtë arsye Gjykata nuk mund t'i rishqyrtojë ato ankesa (shih *Mazepa dhe të Tjerë kundër Rusisë*, nr. 15086/07, §§ 61–62, 17 korrik 2018, dhe *Korporativna Targovska Banka AD kundër Bullgarisë*, nr. 46564/15 dhe 68140/16, § 115, 30 gusht 2022).

### B. Neni 5 § 2 i Konventës

9. Kërkuesi u ankua në mbështetje të nenit 5 § 2 të Konventës se autoritetet vendëse nuk e kishin informuar siç duhej për arsyet e arrestimit të tij dhe akuzat ndaj tij. Megjithatë, Gjykata vlerëson se Qeveria kishte parashtruar se kërkuesi ishte kapur *in flagrante delicto* në posedim të lëndëve narkotike, dhe se vet ai i kishte orientuar oficerët e policisë te një vend i fshehur në banesën e tij ku ai mbante lëndë narkotike dhe një peshore të vogël. Kërkuesi nuk i kundërshtoi këto fakte. Gjykata gjykon se në këto rrethana, kërkuesi nuk mund të pretendojë se nuk e kuptonte se përse ishte arrestuar dhe shoqëruar në rajonin e policisë (krahaso *Dikme kundër Turqisë*, nr. 20869/92, § 54, GJEDNJ 2000-VIII). Në vijim, kërkuesi u mor në pyetje nga policia në praninë e avokatit të tij vetëm pak orë pasi ishte ndaluar nga oficerët e policisë në rrugë dhe ishte bërë me dije për akuzat ndaj tij. Së fundmi, në procesverbalin për arrestimin e tij, të përpiluar në po të njëjtën ditë, kërkuesi u informua përsëri për akuzat ndaj tij. Ky procesverbal iu paraqit menjëherë dhe ai e nënshkroi atë.

10. Duke mbajtur në konsideratë sa më sipër, dhe duke pasur parasysh se neni 5 § 2 nuk parashikon që arsyet për arrestin të jepen në ndonjë formë të caktuar, Gjykata arrin në përfundimin se duhet të gjykohet se kërkuesi ka qenë në dijeni të arsyeve për arrestimin e tij në momentin e, ose menjëherë pas, arrestimit të tij (krahaso *Döner dhe të Tjerë kundër Turqisë*, nr. 29994/02, §§ 47–49, 7 mars 2017).

11. Për sa më sipër, kjo ankesë është qartazi e pambështetur në fakte sipas nenit 35 §§ 3 (a) dhe 4 të Konventës.

### C. Neni 5 § 4 i Konventës

12. Në vijim, kërkuesi u ankua në mbështetje të nenit 5 § 4 të Konventës se atij i ishte ndaluar e drejta që për ndalimin e tij të merrej një vendim i shpejtë nga gjykata, për shkak të mosfunksionimit të pretenduar të Gjykatës së Lartë dhe Gjykatës Kushtetuese.

13. Gjykata thekson se neni 5 § 4 i Konventës i jep të drejtën një personi të arrestuar ose të ndaluar në paraburgim të paraqesë procedurat për shqyrtim nga një gjykatë për kushtet procedurale dhe themelore që janë thelbësore për “ligjshmërinë”, sipas interpretimit të nenit 5 § 1, për privimin e tij ose të saj nga liria (shih *Idalov kundër Ruisë* [DHM], nr. 5826/03, § 161, 22 maj 2012, dhe *Kblajfia dhe të Tjerë kundër Italisë* [DHM], nr. 16483/12, 15 dhjetor 2016).

14. Për sa i përket çështjes konkrete, Gjykata vëren fillimisht se paraburgimi i kërkuesit ishte urdhëruar nga një organ gjyqësor, më konkretisht Gjykata e Apelit Tiranë. Në vijim, Gjykata thekson se neni 5 § 4 nuk i detyron Shtetet Kontraktuese të krijojnë një juridiksion të nivelit të dytë për shqyrtimin e ligjshmërisë së ndalimit (shih *Stevan Petrović kundër Serbisë*, nr. 6097/16 dhe 28999/19, § 177, 20 prill 2021). Sidoqoftë, një Shtet që e krijon një sistem të tillë, në parim, duhet t’u ofrojë të ndaluarve të njëjtat garanci për apelim si në shkallën e parë (shih *Fodale kundër Italisë*, nr. 70148/01, 39, GJEDNJ 2006-VII).

15. Në sistemin shqiptar, apelimi në Gjykatën e Lartë në parim është i mundur ndaj vendimeve gjyqësore të shkallës së dytë. Megjithatë, këto apeline duhet të kufizohen brenda disa shkaqeve të parashikuara në nenin 432 të Kodit të Procedurës Penale. Duke qenë se kërkuesi nuk u mbështet në asnjërën prej këtyre arsyeve, apelimi i tij u rrëzua (shih paragrafin 6 më sipër). Në këtë linjë, gjykata thekson se Shtetet mund të kufizojnë aksesin në gjykatat më të larta dhe se kushtet e pranueshmërisë së një apelimi për pika të ligjit ose të një apelimi në një gjykatë më të lartë – si për shembull Gjykata e Lartë – mund të jenë më strikte sesa për një apelim të zakonshëm (shih *Zubac kundër Kroacisë* [DHM], nr. 40160/12, § 82, 5 prill 2018). Këto kufizime mund të vendosen, *inter alia*, duke kufizuar shkaqet e apelimit pranë këtyre gjykatave.

16. Në apelimin e tij ndaj vendimit që urdhëronte ndalimin e tij, kërkuesi u ankua se nuk kishte dyshim të arsyeshëm se ai kishte kryer një vepër penale dhe nuk kishte arsye për ndalimin e tij, se nuk ishte informuar menjëherë pasi ishte arrestuar për akuzat ndaj tij, dhe se avokatit të tij nuk i ishte dhënë ndonjë dokument, në lidhje me akuzat në mënyrë që ai të mund të përgatiste mbrojtjen e kërkuesit (shih paragrafin 5 më sipër). Gjykata thekson se Gjykata e Apelit Tiranë kishte dhënë arse të mjaftueshme dhe të përshtatshme, në lidhje me urdhrin për paraburgimin e kërkuesit (shih paragrafin 4 më sipër).

17. Së fundmi, periudha më pak se tre muaj që Gjykata e Lartë të vendoste për apelimin e kërkuesit nuk duket të jetë e tepërt, duke qenë se standardi për “shpejtësi” është më pak i rreptë kur është rasti i procedurave në gjykatën e apelit (shih *Starokadomskij kundër Ruisë*, nr. 42239/02, § 80, 31 korrik 2008, me referenca të mëtejshme).

18. Sa më sipër, ankesa është qartazi e pambështetur në fakte dhe duhet të rrëzohet në përputhje me nenin 35 §§ 3 (a) dhe 4 të Konventës.

Për këto arsye, Gjykata, në mënyrë unanime:

*E shpall* kërkesën të papranueshme.

Hartuar në anglisht dhe njoftuar me shkrim më 4 korrik 2024.

**Olga Chernishova**  
ZËVENDËSSEKRETARE

**Ioannis Ktistakis**  
KRYETAR